



SIGURIA E FËMIJËVE NË INTERNET

DHJETOR 2016



Save the Children



Qendra për studime të avancuara
Center for advanced studies

SIGURIA E FËMIJËVE NË INTERNET

Prishtinë, Dhjetor,
2016



Autorët:

Teuta Zymeri
Anil Gashi
Liridon Latifi

Implementuar nga:

Qendra për studime të avancuara – FIT
Eqrem Qabej, Nr. 166
10000 Prishtinë, Kosovë
info@fit-ks.org
info@internetisigurte.org
www.fit-ks.org
www.internetisigurte.org

Koordinuar nga:

Save The Children në Kosovë

Dizajni, faqosja, korrigjimi:

Envinion

Botuar nga:

Save the Children
Gazmend Zajmi, nr. 01
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0) 38 23 26 91
Faks: +381 (0) 38 23 26 93
Scik@savethechildren.org
http://Kosovo.savethechildren.net

© Dhjetor 2016 “Save the Children”

Ky publikim është i mbrojtur nga e drejta e autorit. Mund të kopjohet për qëllime edukative, por jo për shitje. Për çfarëdo lloj përdorimi paraprakisht duhet të merret leja nga botuesi. Mendimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë mendimet e organizatës “Save the Children”.

Për organizatën “Qendra për Studime të Avancuara FIT”

Qendra për Studime të Avancuara FIT (Qendra FIT) është organizatë e pavarur joqeveritare e themeluar në vitin 2011 me vizion për të qenë organizatë që kontribuon në krijimin e një shoqërie të shëndoshë. Qendra FIT angazhohet në përmirësimin e gjendjes te grupet më të ndjeshme të shoqërisë, nëpërmjet aktiviteteve hulumtuese, avokuese, edukuese dhe vetëdijesuese.

Për organizatën “Save the Children”

Save the Children është organizatë e pavarur me fokus fëmijët dhe punon në rreth 120 vende të botës. Save the Children në Kosovë punon prej vitit 1997, duke realizuar programe të reagimit emergjent dhe zhvillimit në fushën e arsimit, mbrojtjes së fëmijëve dhe rregullimit të të drejtave të fëmijëve në gjithë Kosovën.

Falënderime

Falënderojmë të gjithë ata që morën pjesë në hartimin e këtij raporti dhe na ndihmuan gjatë gjithë kohës së realizimit të hulumtimit. Në veçanti falënderojmë Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për mbështetjen e dhënë në realizimin e hulumtimit tonë në katërmbëdhjetë shkolla fillore të Kosovës. Gjithashtu falënderojmë stafin e shkollave fillore “Ibrahim Fehmiu” dhe “Motrat Qiriazhi” (Prizren), “Migjeni” dhe “Andon Zako Çajupi” (Mitrovicë), “Naim Frasheri” dhe “Emin Duraku” (Prishtinë), “Ramiz Sadiku” dhe “Xhemajl Kada” (Pejë), “Tefik Çanga” dhe “Jeronim de Rada” (Ferizaj), “Thimi Mitko” dhe “Selami Hallaçi” (Gjilan) si dhe “Zekeria Rexha” dhe “Yll Morina” (Gjakovë) për ndihmën e dhënë gjatë procesit të hulumtimit.

Falënderojmë studentet e Universitetit të Prishtinës, të Fakultetit të Matematikës dhe Edukimit: Beneta Avdimetaj, Gresa Bajraktaraj, Mirjeta Shatri dhe Donjeta Shatri që punuan gjatë gjithë kohës së realizimit të hulumtimit.

Falënderojmë prindërit e fëmijëve për bashkëpunim si dhe në fund ju jemi shumë mirënjohës fëmijëve që treguan gatishmëri për plotësimin e pyetësorit, pa të cilët do të ishte i pamundur realizimi i këtij hulumtimi.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE	9
HYRJE	11
METODOLOGJIA.....	12
Kufizimet dhe sfidat.....	13
PËRDORIMI I INTERNETIT	14
Sa e përdorin fëmijët internetin?	14
Mënyra e qasjes në internet	16
Njohuritë digjitale dhe masat e sigurisë	18
Përdorimi i (pa)monitoruar i internetit	18
AKTIVITETET E FËMIJËVE NË INTERNET	20
Aktivitetet kryesore	20
Rrjetet Sociale	21
Video lojërat në internet.....	22
RREZIQET PËR FËMIJË NGA PËRDORIMI I PA MONITORUAR I INTERNETIT	24
Përmbajtja e materialeve të papërshtatshme në internet	24
Takimi me njerëz të panjohur	27
Rreziqet tjera.....	30
Publikimi i të dhënave personale.....	30
Keqpërdorimi i të dhënave personale.....	31
SAJBËRDHUNA (DHUNA NËPËRMJET TEKNOLOGJISË)	33
Identifikimi i sajërdhunës	33
Format e sajërdhunës	35
Si përballen moshat e reja me sajërdhunën	36
Efektet e sajërdhunës.....	38
REKOMANDIME	40

LISTA E FIGURAVE

■ Figura 1: Përdorimi i internetit nga fëmijët dhe prindërit	14
■ Figura 2: Sa shpesh e përdorin fëmijët internetin?	15
■ Figura 3: Sa gjatë qëndrojnë fëmijët në internet gjatë një dite?	15
■ Figura 4: Pajisjet të cilat i përdorin fëmijët për t'u lidhur në internet.....	16
■ Figura 5: Ku e përdorin fëmijët internetin?	17
■ Figura 6: Sa ndihen të sigurt fëmijët gjatë përdorimit të internetit?	18
■ Figura 7: Aktivitetet e fëmijëve në internet të lejuara nga prindërit (2016).....	19
■ Figura 8: Aktivitetet e preferuara të fëmijëve në internet	20
■ Figura 9: Numri i shokëve që i kanë fëmijët në rrjete sociale (2016)	21
■ Figura 10: Fëmijët që luajnë lojëra në internet	22
■ Figura 11: Çfarë lojërash luajnë fëmijët në internet?	23
■ Figura 12: Fëmijët kanë parë imazhe me përmbajtje të papërshtatshme	25
■ Figura 13: A janë shqetësuar fëmijët nga shikimi i imazheve me përmbajtje të papërshtatshme	26
■ Figura 14: Fëmija është takuar me dikë të panjohur të cilin për herë të parë e ka kontaktuar nëpërmjet internetit	27
■ Figura 15: Numri i njerëzve të panjohur që fëmijët i kanë takuar ballë për ballë.....	28
■ Figura 16: Numri i personave të panjohur që fëmijët kanë takuar dhe janë shqetësuar nga ky takim	28
■ Figura 17: Mosha e personave të panjohur që fëmijët kanë takuar dhe janë shqetësuar nga ky takim	29
■ Figura 18: Të dhënat personale të cilat fëmijët i postojnë në internet	30
■ Figura 19: Fëmijët që kanë hasur në probleme të ndryshme gjatë përdorimit të internetit në vitin e fundit	31
■ Figura 20: Ngacmimet e fëmijëve nëpërmjet internetit ose ndonjë mënyre tjetër në vitin e fundit	34
■ Figura 21: Mënyrat se si janë ngacmuar fëmijë nëpërmjet internetit	35
■ Figura 22: Fëmija ka qenë i shqetësuar nga ngacmimi në internet	36
■ Figura 23: Me kënd ka biseduar fëmija pasi ka qenë i ngacmuar në internet	37
■ Figura 24: Reagimi i fëmijëve nga përmbajtja në internet	38

LISTA E TABELAVE:

■ Tabela 1: Ndërmjetësimi i mësuesve në sigurinë e fëmijëve në internet (në përqindje).....	18
■ Tabela 2: Sa shpesh është ngacmuar fëmija në vitin e fundit	34
■ Tabela 3: Çfarë ka bërë fëmija pasi ka qenë i ngacmuar nëpërmjet internetit	37
■ Tabela 4: Karakteristikat shoqërore dhe psikologjike të fëmijëve (2016).....	38
■ Tabela 5: Karakteristikat shoqërore dhe psikologjike të fëmijëve (2014).....	39

PËRMBLEDHJE

Ky raport paraqet një pjesë të të gjeturave në hulumtimin e bërë nga Qendra FIT dhe Save the Children në Kosovë (SCIK). Qëllimi i hulumtimit ka qenë që të grumbullohen informata në terren lidhur me përdorimin e internetit nga ana e fëmijëve, mënyrën se si ata qasen, identifikimin e rreziqeve potenciale kur ata lidhen online dhe që nëpërmjet raportit të paraqiten rezultatet nga përgjigjet e fëmijëve. Ky raport në radhë të parë përshkruan sjelljen e fëmijëve në internet dhe më pas shtjellon rreziqet që lidhen me përdorimin e internetit. Të dhënat janë mbledhur nga një pyetësor me 1301 fëmijë të moshës 9-15 vjeç nga shtatë komunat më të mëdha të Kosovës. Pasiqë një hulumtim i ngjajshëm është bërë edhe në vitin 2014, Qendra FIT dhe SCIK do të përdorin këto dy hulumtime për të parë se sa ka pasur impakt projekti «Promovimi i Përdorimit të Internetit në mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme nga ana e fëmijëve» në krijimin e një ambienti më të sigurt për fëmijët gjatë përdorimit të internetit.

Objektivi i përgjithshëm i këtij Raporti është studimi i sjelljeve të fëmijëve në internet dhe vlerësimi i njohurive të tyre në lidhje me çështjet e sigurisë në internet. Raporti përmban pesë kapituj: Hyrja, Përdorimi i internetit, Aktivitetet online, Rreziqet dhe Rekomandimet. Hyrja shpjegon në detaje qëllimin dhe metodologjinë e përdorur për hartimin e këtij Raporti, ndërsa kapitujt pasues përmbajnë pjesën kryesore të informatave mbi aktivitetet kryesore të fëmijëve në internet dhe rreziqet potenciale.

Disa nga temat të cilat janë trajtuar në fillim të këtij Raporti tregojnë se çfarë bëjnë fëmijët kur janë të lidhur në internet; cilat janë aktivitetet e tyre më të pëlqyera e më të shpeshta; sa aktiv janë në rrjete sociale; sa kanë njohuri digjitale për identifikimin e rreziqeve online. Më pas, në Raport janë adresuar rreziqet më kryesore me të cilat përballen fëmijët gjatë aktivitetit online, përfshirë: shikimi i përmbajtjeve të papërshtatshme për moshën e tyre (psh. pornografia, dhuna); takimi me njerëz të panjohur; publikimi e keqpërdorimi i të dhënave personale, dhe sajberdhuna. Gjithashtu, Raporti përshkruan format dhe efektet e sajberdhunës dhe mekanizmat që fëmijët përdorin për t'u përballuar me ngacmimet në internet. Kapitulli i fundit paraqet konkluzionet e studimit dhe rekomandimet për akterët relevant, siç janë fëmijët, prindërit, mësuesit, politikëbërësit, si dhe industrinë e telekomunikacionit.

Gjetjet e këtij studimit tregojnë se fëmijët e anketuar janë përdorues shumë aktiv të internetit. Përdorimi i internetit nga ana e fëmijëve, krahasuar me studimin e bërë në vitin 2014, është në rritje. Fëmijët e përdorin internetin kryesisht për qëllime argëtuese dhe komunikim. Shumica e fëmijëve kanë raportuar se aktivitetet e tyre më të preferuara në internet janë rrjetet sociale, si: YouTube, Instagrami, Facebook e Snapchat. Përdorimi në masë të madhe i telefonave të mençur dhe mundësia e lehtë për t'u lidhur në internet në çdo kohë e çdo vend limiton dhe vështirëson monitorimin e aktiviteteve të fëmijëve online nga ana e prindërve apo kujdestarëve. Kjo u mundëson fëmijëve përdorim të internetit në mënyrë të pavarur dhe pa mbikëqyrje nga të rriturit.

Në përgjithësi, vlerësohet se fëmijët përfaqësojnë një përqindje të lartë të përdoruesve të internetit. Interneti në ditët e sotme luan rol të rëndësishëm në identitetin dhe formësimin jetësor të fëmijëve. Rrjedhimisht, vetëdijësimi i shoqërisë për rreziqet e mundshme, krijimi dhe përmirësimi i mekanizmave mbrojtës për siguri në internet dhe njohja më e mirë e përdorimit të internetit nga prindërit janë mënyra të duhura që mund të rezultojnë në përdorim më të mirë dhe më të sigurt të internetit nga ana e fëmijëve.

HYRJE

Me zhvillimin e hovshëm të teknologjisë vërehet edhe rritja e dukshme e qasjes së fëmijëve në internet, përfshirë ata të moshave shumë të reja. Krahas rritjes së vazhdueshme të numrit të fëmijëve që përdorin internetin nëpërmjet pajisjeve të ndryshme elektronike, rriten edhe mundësitë për të mësuar gjëra të reja në internet, por, njëkohësisht rritet edhe ekspozimi i fëmijëve ndaj rreziqeve të ndryshme kur lidhen të pasigurt online.

Padyshim se përdorimi i kujdesshëm i internetit ndihmon fëmijët të mësojnë më shumë për botën dhe mund të shërbejë si një mjet i dobishëm për zhvillimin e tyre akademik e personal. Mirëpo, nëse nuk përdoret në mënyrë të kujdesshme dhe pa mbikëqyrje nga të rriturit, qasja e fëmijëve në internet mund të rezultojë e dëmshme dhe paraqet rreziqe serioze fizike e psikologjike. Rreziku i abuzimit të fëmijëve në internet për shkak të mungesës së kontrollit nga prindërit, kujdestarët dhe edukatorët e tyre është më i shprehur gjatë përdorimit të rrjeteve sociale. Inkurajimi i përdorimit të sigurt dhe të përgjegjshëm të internetit si dhe njohuritë mbi rreziqet potenciale janë hapa të rëndësishëm drejt ndërtimit të një platforme të menaxhimit të rrezikut për të mbajtur fëmijët të sigurt në internet.

Aktivitetet e dëmshme dhe të rrezikshme për fëmijët, siç janë shikimi i përmbajtjeve pornografike apo sajbërdhuna, shpesh ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin mental të fëmijëve. Këto shpeshherë shoqërohen me rritje të sjelljeve agresive të fëmijëve si në shkolla ashtu edhe në shoqëri. Duke pasur parasysh mungesën e hulumtimeve në Kosovë në këtë fushë, ky hulumtim ka për qëllim të ofrojë informata se si fëmijët e përdorin internetin dhe të përshkruaj disa rreziqe të mundshme nga aktivitetet e tyre online.

Fëmijët janë pasuria më e vlefshme e Kosovës pasi që ata përfaqësojnë të ardhmen e vendit tonë. Për më tepër, fëmijët janë anëtarët më të ndjeshëm të shoqërisë dhe mbrojtja e tyre duhet të jetë prioritet për hartuesit e politikave. Për fat të keq, të njëjtat zhvillime teknologjike që ju mundësojnë fëmijëve të fitojnë shumë njohuri për botën, po i lënë ata të pambrojtur nga shfrytëzimi dhe përdorimi i sigurt i tyre. Raporti i mëposhtëm ka për qëllim të informojë fëmijët, prindërit, mësuesit dhe hartuesit e politikave në Kosovë në lidhje me kompleksitetin dhe rreziqet nga aktivitetet a pa kontrolluara online.

METODOLOGJIA

Ky është raport krahasues me raportin e dalë nga hulumtimi i ngjashëm i bërë në vitin 2014 dhe në radhë të parë përshkruan sjelljen e fëmijëve në internet dhe më pas shtjellon rreziqet që lidhen me përdorimin e internetit.

Të dhënat janë mbledhur nga një pyetësor i dizajnuar nga Qendra FIT i realizuar me 1301 respondent, fëmijë të moshës 9-15 vjeç. Pyetësi është mbajtur në tetor 2016 në shtatë komunat më të mëdha të Kosovës. Në secilën komunë janë zgjedhur nga dy shkolla, gjithsej 14 shkolla fillore me nxënës të klasave IV-IX.

Komunat	Shkollat pjesëmarrëse	Nr. i nxënësve
Prizren	“Ibrahim Fehmiu” dhe “Motrat Qiriazhi”	157
Prishtinë	“Naim Frashëri” dhe “Emin Duraku”	177
Mitrovicë	“Migjeni” dhe “Andon Zako Çajupi”	210
Pejë	“Ramiz Sadiku” dhe “Xhemajl Kada”	211
Ferizaj	“Tefik Çanga” dhe “Jeronim De Rada”	201
Gjilan	“Thimi Mitko” dhe “Selami Hallaqi”	147
Gjakovë	“Zekeria Rexha” dhe “Yll Morina”	198

Siç u përmend më lart, një hulumtim i ngjashëm është bërë nga Qendra FIT dhe Save the Children edhe në vitin 2014 në të njejtat komuna por në 7 shkolla, duke përfshirë 1150 nxënës.

Përveç marrjes së lejes nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), për të zhvilluar pyetësin me fëmijë të shkollave të planifikuara, ne kemi kërkuar që çdo fëmijë të ketë lejen edhe nga prindërit e tyre për të marrë pjesë në hulumtim. Një leje paraprake është dorëzuar te prindërit të cilët kanë autorizuar pjesëmarrjen e fëmijëve në pyetësor.

Janë zhvilluar dy lloje të pyetësorëve për grupmosha të ndryshme. Pyetësi për fëmijët e moshës 9-11 vjeç (klasat IV-V) ka përmbajtur 47 pyetje; ndërsa ai për fëmijët e moshës 12-15 vjeç (klasat VI-IX) ka përmbajtur 50 pyetje, duke përfshirë edhe 3 pyetje shtesë në lidhje me përmbajtjen seksuale online.

Për fëmijët e klasave katër (IV) dhe pesë (V) është bërë leximi dhe shpjegimi me zë të lartë i pyetjeve në klasë. Kjo është bërë me qëllim që pyetjet të jenë të qarta para se ata të përgjigjen. Fëmijët gjithashtu kanë pasur mundësinë të bëjnë pyetje (me zë të lartë ose individualisht) për çfarëdo paqartësi rreth pyetësorit. Kjo metodë është përdorur për të gjitha pyetjet në pyetësor.

Para se të finalizohet pyetësi, është bërë një pilotim i tij për të eliminuar/përmirësuar pyetjet komplekse dhe për ta bërë pyetësin funksional. Disa nga pyetjet janë modifikuar për të qenë më të thjeshta dhe më lehtë të kuptueshme. Pas pilotimit janë shtuar më shumë udhëzime në disa pyetje dhe është finalizuar pyetësi.

Në përpjekje për të krijuar një ambient sa më të relaksuar, fëmijëve të klasave VI-IX ua kemi dhënë pyetësorët që t'i plotësojnë në shtëpi. Pyetësorët kanë qenë të mbyllur në kovertë dhe të mbyllur i kanë kthyer përsëri në shkollë. Pyetësorët kanë qenë anonim dhe se emrat e fëmijëve nuk janë regjistruar në pyetësor. Pyetësi ka qenë plotësisht konfidencial.

Për pyetjet më të ndjeshme, siç janë ato për shikimin e pamjeve me përmbajtje të papërshtatshme erotike, janë dhënë shpjegime më të detajuara. Kurse, për pyetjet që mund të konsiderohen si më të vështira apo të turpshme për t'u përgjigjur, fëmijëve u janë dhënë opsionet “nuk e di” ose “preferoj të mos përgjigjem”. Në përgjithësi, janë shfrytëzuar një numër i vogël i këtyre opsioneve; megjithatë, për qëllime etike ishte e rëndësishme që mundësitë e tilla të vihen në dispozicion.

Kufizimet dhe sfidat

Pyetësi është dizajnuar me kujdes dhe ka pasë një administrim profesional nga ekspertët e fushës gjatë punës në terren. Megjithatë, raporti ka kufizime të cilat duhet të merren parasysh gjatë interpretimit të të dhënave. Përveç kësaj, ka pasur disa sfida gjatë hulumtimit.


Sfidë e veçantë ka qenë kontakti dhe aranzhimi i takimeve me përfaqësuesit e shkollave fillore dhe marrja e lejeve nga prindërit. Gjithashtu, qasja e mangët te fëmijët për kontakt direkt për t'iu dhënë sqarime shtesë me rastin e plotësimit të pyetësorit ka qenë një sfidë tjetër. Vështirë ka qenë gjithashtu formulimi dhe përgatitja e pyetjeve të drejtpërdrejta për çështjet që kanë pasur të bëjnë me përmbajtjet e ndjeshme/seksuale. Pyetësi është plotësuar nga fëmijët në shtëpi dhe ka një mostër shumë të gjerë (1,301 respondentë). Megjithatë, pamundësia për të përfshirë fëmijët e zonave rurale, e kufizon gjetjen e një mesatareje gjithpërfshirëse në nivel të vendit.

PËRDORIMI I INTERNETIT

Sa e përdorin fëmijët internetin?


Ngjashëm si në anketën e vitit 2014, edhe në vitin 2016 fëmijët kanë deklaruar se e përdorin internetin dukshëm më shumë se sa prindërit e tyre. Përgjatë periudhës krahasuese, mund të shihet se përdorimi i internetit nga fëmijët është rritur nga 93% në 97%, ndërsa edhe tek prindërit përdorimi i internetit ka shënuar rritje nga 76% në 81%. Pothuajse të gjithë fëmijët e moshës 13 vjeç e më shumë kanë deklaruar se e përdorin internetin. Nga 589 persona të kësaj moshe të intervistuar, vetëm njëri prej tyre ka deklaruar se nuk e përdor internetin. Përqindje shumë të lartë ka deklaruar edhe mosha e nëntë vjeçarve (nga 131 vetëm dy persona kanë deklaruar se nuk e përdorin internetin).

■ **Figura 1:** Përdorimi i internetit nga fëmijët dhe prindërit




Fëmijët janë përgjigjur në pyetjen: Sa shpesh e përdorin internetin? (figura 2). Shohim një rritje sa i përket shpeshësisë së përdorimit të internetit si nga fëmijët ashtu edhe nga prindërit e tyre. Të gjeturat tregojnë se përdorimi i internetit 'çdo ditë ose gati çdo ditë' ka shënuar rritje nga 65% në 71%, derisa përdorimi i internetit 'një ose dy herë në javë' ka shënuar rënjë (13% në vitin 2016 nga 18% sa ishte në vitin 2014). Ndërsa sa i përket frekuencës 'një ose dy herë në muaj apo më rrallë', nuk shohim ndonjë ndryshim të madh gjatë viteve krahasuese.

■ **Figura 2:** Sa shpesh e përdorin fëmijët internetin?



Sa i përket orëve të shpenzuara në internet nga fëmijët që kanë qasje çdo ditë, vërehet një rritje e kohës së qëndrimit online. Nga figura e mëposhtme shihet se përqindja e fëmijëve që qëndrojnë 'më shumë se katër orë' në internet është rritur, kurse e atyre që qëndrojnë 'më pak se dy orë' është zvogëluar. Sipas përgjigjeve, rreth 40% e fëmijëve shpenzojnë 'më pak se 1 orë' në internet (47% ishte në 2014), kurse rreth 32% qëndrojnë '1-2 orë online'. Çfarë mbetet shumë shqetësuese është se 9% e fëmijëve shpenzojnë 'më shumë se 4 orë në internet' gjatë ditës (4% ishte në 2014). Sa i përket gjinisë, rezultatet nga anketa tregojnë se djemtë qëndrojnë dukshëm më gjatë në internet, krahasuar me vajzat. Për shembull, në kategorinë e atyre që qëndrojnë mbi katër orë në internet gjatë ditës, rreth 63% e tyre janë djemë; kurse në kategorinë që rrijnë më pak se një orë online, rreth 61% e tyre janë vajza. Sa i përket moshës, katërmëdhjetë vjeçarët dhe trembëdhjetë vjeçarët janë ata që qëndrojnë më gjatë në internet.

■ **Figura 3:** Sa gjatë qëndrojnë fëmijët në internet gjatë një dite?




Mënyra e qasjes në internet

Rritja e përdorimit të telefonave të mençur përkon me një rritje tepër të madhe të përdorimit të internetit prej fëmijëve nga këto pajisje. Në 2016, rreth 87% e fëmijëve kanë deklaruar se lidhen në internet nëpërmjet telefonave mobil, krahasuar me 57% në vitin 2014. Një e gjetur shumë interesante tregon se lidhjet në internet nga kompjuteri kanë rënë nga 72% në vitin 2014 në vetëm 48% në 2016. Një tjetër rritje është shënuar në lidhjet nga Ipad apo pajisjet tjera teknologjike nga 11% që ishte në vitin 2014 në 26% në vitin 2016. Sa i përket lidhjes në internet nga lllaptopi, situata pothuajse nuk ka ndryshuar.

Nëse bazohemi në faktin që fëmijët sot më shumë po e përdorin internetin nga telefoni mobil apo Ipad, dhe nëse ata dijnë më shumë rreth internetit sesa prindërit e tyre, atëherë edhe monitorimi i aktiviteteve të fëmijëve nga prindërit e tyre është më i vështirë. Rezultatet nuk tregojnë ndonjë dallim në qasjen në internet nëpërmjet telefonave mobil sa i përket gjinisë apo moshës.

■ **Figura 4:** Pajisjet të cilat i përdorin fëmijët për t'u kyçur në internet




Për të parë se sa e preferojnë fëmijët privatësinë dhe më saktësisht nga cili ambient qasen në internet, njëra ndër pyetjet për fëmijët ka qenë: Nga ku e përdorin më së shpeshti internetin. Në vitin 2016 një gjë pozitive është që 93% të fëmijëve kanë theksuar se e përdorin internetin në shtëpi në dhomë të ndejës, krahasuar me 76% në vitin 2014. Arsyeja pse kjo është një gjë pozitive, është për faktin se monitorimi në shtëpi është më i lehtë nga ana e prindërve në dhomën e ndejës. Sidoqoftë, kjo nuk garanton se edhe fëmijët që e përdorin internetin në dhomën e ndejës nuk shikojnë përmbajtje të papërshtatshme për moshën e tyre.

Shqetësim në vete është rritja e përdorimit të internetit në shtëpi në dhomë të fjetjes, nga 60% në vitin 2014 në 79% në vitin 2016. Monitorimi nga ana e prindërve është më i vështirë nëse fëmijët e përdorin internetin në dhomë e fjetjes. Fëmijët më në moshë, posaçërisht djemtë, janë ata që kanë një përqindje pak më të lartë që bëjnë pjesë në këtë kategori.

Kjo e bën më të vështirë mbikqyrjen e aktiviteteve të fëmijëve online. Te përdorimi i internetit në shkollë nuk ka ndonjë ndryshim të madh, pasi që shkollat në Kosovë në përgjithësi ofrojnë pak mundësi të përdorimit të internetit nga kompjuterët e shkollave. Dukuri tjetër shqetësuese është rritja e përdorimit të internetit në 'Internet kafe'. Në vitin 2016, rreth 34% e fëmijëve kanë deklaruar se e përdorin internetin në 'Internet kafe', në krahasim me 22% në vitin 2014. Dihet se në internet kafe monitorimi i aktiviteteve online është shumë i ulët apo fare nuk ekziston në Kosovë. Fëmijët zakonisht i frekuentojnë internet kafetë para dhe pas orarit mësimor. Djemtë kyçen më shumë nga internet kafetë (rreth 60% e fëmijëve); kurse sa i përket moshës, ata që janë më të rritur i frekuentojnë më shumë (64% e fëmijëve janë të moshës 13 vjeçarë e më shumë).


■ **Figura 5:** Ku e përdorin fëmijët internetin?



Njohuritë digjitale dhe masat e sigurisë

Në bazë të rezultateve të vitit 2016 ka rezultuar që më shumë se gjysma e fëmijëve ndjehen pak të sigurt për të shfletuar dhe për të kërkuar informacione në internet. Për më shumë, ka një rënie relativisht të vogël sa i përket ndjenjës së sigurisë që fëmijët e kanë gjatë përdorimit të internetit. Vetëm rreth 30% e fëmijëve kanë deklaruar që ndihen shumë të sigurt online, përderisa në vitin 2014 kjo përqindje ka qenë rreth 35%.

■ **Figura 6:** Sa ndihen të sigurt fëmijët gjatë përdorimit të internetit?



Përdorimi i (pa)monitoruar i internetit

Fëmijët janë pyetur nëse mësuesit u kanë ofruar këshilla për sigurinë e fëmijëve në internet. Rreth 62% e fëmijëve në vitin 2016 kanë deklaruar që mësuesit u kanë treguar se si të veprojnë në internet, në krahasim me 54% në vitin 2014. Mirëpo, në 2016 vërehet një rënie për rastet kur mësuesit u kanë ndihmuar kur fëmijët kanë hasur në vështirësi (50% në 2016 krahasuar me 58% në 2014). Në kategoritë tjera, gjatë periudhës krahasuese, nuk shohim ndryshime të mëdha në përgjigjet e fëmijëve.


■ **Tabela 1:** Ndërmjetësimi i mësuesve në sigurinë e fëmijëve në internet

Mësuesit kanë:	2014	2016
Treguar se si të veprojnë në internet	54	62
Ndihmuar kur keni hasur në vështirësi	58	50
Sqaruar pse disa ueb faqe janë të mira apo të dëmshme	60	61
Sugjeruar mënyra për të përdorur internetin në mënyrë të sigurt	55	58
Sugjeruar mënyra se si të silleni me personat tjerë në internet	47	50
Sqaruar se çka duhet të bëni nëse hasni në përmbajtje shqetësuese në internet	39	44

Në vijim ne kemi pyetur fëmijët se ‘cilat aktivitete janë të lejuar t’i bëjnë në internet nga prindërit e tyre’. Figura 7 tregon që në kategorinë mund ta bëjë këtë në çdo kohë, në vitin 2016, rreth 14% e fëmijëve në Kosovë japin informata personale të tjerët në internet (28% ishte në 2014). Në të njëjtën kategori (mund ta bëjë këtë në çdo kohë), në vitin 2016, fëmijët mund të posedojnë profilin e tyre në internet (45%), në krahasim me 55% në vitin 2014. Sa i përket shikimit të videoklipeve në internet (p.sh. YouTube), nuk kemi ndonjë ndryshim të madh përgjatë periudhës krahasuese (71% në vitin 2014 kundrejt 72% në 2016). E njëjta vlen edhe për shkarkimin e muzikës ose filmave në internet dhe përdorimit të mesazheve.

Si përfundim: këto të dhëna tregojnë që prindërit ushtrojnë kontroll të pakët sa i përket sjelljes së fëmijëve të tyre online.

■ **Figura 7:** Aktivitetet e fëmijëve në internet të lejuara nga prindërit (2016)



AKTIVITETET E FËMIJËVE NË INTERNET


Aktivitetet kryesore

Te aktivitetet kryesore të preferuara të fëmijëve në internet në vitin 2016 prinë YouTube me 79%, pasuar nga Instagram me rreth 70%, Muzika me rreth 64%, Wikipedia me rreth 56%, Facebook me rreth 52% dhe Snapchat me rreth 50%. Vërehet rënie në përdorimin e Facebook nga 74% sa ishte në 2014 në rreth 52% në vitin 2016. Një tjetër ndryshim është rritja e ndjeshme në popullaritet e aplikacionit Instagram nga rreth 21% në vitin 2014 në rreth 70% në vitin 2016.

Rradhitja e Instagram në vendin e parë sa i përket përdorimit të rrjeteve sociale mund të jetë shqetësuese në kontekst të sigurisë së fëmijëve në internet, pasi që ky aplikacion përdoret kryesisht për postimin e fotove dhe videove të shkurtëra. Për më shumë, Instagram përdoret më shumë nga gjeneratat e reja dhe prindërit e fëmijëve shpeshherë nuk kanë njohuri të mjaftueshme për të monitoruar fëmijët e tyre në këtë aplikacion.

Instagram është lansuar për herë të parë si aplikacion në vitin 2010 dhe menjëherë ka fituar një popullaritet të fuqishëm te të rinjtë. Në fund të 2016 kishte rreth 500 milion përdorues aktiv dhe numri vazhdon të rritet çdo ditë. Në mes të këtyre miliona përdoruesve, shumë prej tyre përdorin të dhëna personale të rreme me qëllim për t'u shoqëruar dhe takuar me të rinj, takime të cilat shpeshherë sjellin rreziqe të ndryshme.

■ **Figura 8:** Aktivitetet e preferuara të fëmijëve në internet




Rrjetet Sociale

Për shumicën e fëmijëve Kosovarë përdorimi i rrjeteve sociale është përditshmëri dhe pjesë aktive e jetës së tyre. Tek të rinjtë Kosovar, përdorim më të gjerë kanë rrjetet sociale Instagram, Facebook dhe Snapchat. Rritja në numër e fëmijëve që kanë telefona të mençur rrit edhe përdorimin e rrjeteve sociale nga ana e tyre. Të dhënat nga të anketuarit tregojnë se përdorimi i rrjeteve sociale është pjesa më e preferuar gjatë përdorimit të internetit.

Shqetësues është fakti se kemi rritje drastike në numrin e përdoruesëve të Instagramit nga fëmijët Kosovarë (nga 22% në 70%) dhe poashtu një përdorim mjaft të madh të rrjetit social Snapchat (50%). Krahasuar faktin se Facebooku mund t'iu shërbejë fëmijëve edhe për ngritje profesionale pasi që ka materiale të shumta me porosi edukative, vështirë është të konstatohet e njëjta edhe për rrjetet sociale Instagram dhe Snapchat, pasi që të dyjat shërbejnë vetëm si mjet komunikimi virtual. Fëmijët kanë përfitime të ndryshme nga përdorimi i rrjeteve sociale nëse ato përdoren si duhet. Sidoqoftë, me gjithë mundësitë e mira që ofrojnë këto rrjete sociale, paraqiten edhe rreziqe të natyrave të ndryshme që te fëmijët mund të ndikojnë shumë negativisht. Viruset e ndryshme, sajberdhuna, takimet me njerëz të panjohur të cilët i njoftojnë vetëm nëpërmjet rrjeteve sociale janë vetëm disa nga rreziqet që fëmijët i hasin gjatë përdorimit të rrjeteve sociale.

■ **Figura 9:** Numri i shokëve që i kanë fëmijët në rrjete sociale (2016)



Fëmijët, përveç se kalojnë kohë të gjatë në rrjete sociale, ata kanë shumë miq me të cilët janë të lidhur në këto rrjete. Sipas përgjigjeve të fëmijëve, rreth 35% e fëmijëve të moshës 13 vjeç kanë mbi 400 shokë në rrjetet sociale (28% ishte në 2014). Rreth 68% e këtyre fëmijëve që i kanë mbi 400 shokë në rrjetet sociale i përkasin gjinisë mashkullore.


Rrjetet sociale si Facebook, Instagram dhe Snapchat kërkojnë që të gjithë përdoruesit të jenë së paku 13 vjeç para se të mund të krijojnë llogari në rrjete sociale. Sidoqoftë, në bazë të figurës më lart vërehet se fëmijët hapin llogari në rrjete sociale duke paraqitur vit të lindjes që nuk është i vërtetë.

Sa më shumë shokë që kanë fëmijët në rrjete sociale dhe sa më të rinj që ata janë, aq më i lartë është rreziku i tyre që të hasin në probleme të ndryshme gjatë përdorimit të internetit. Vlen të theksohet, se sa më të rinjë janë fëmijët aq më pak kanë njohuri për rregullimin e privatësisë në rrjete sociale, kjo automatikisht shton shkallën e rrezikut për fëmijë.

Video lojërat në internet


Përveç profileve në rrjetet sociale, video lojërat online gjithashtu ofrojnë një platformë shumë atraktive për fëmijët. Për shkak të avancimit të teknologjisë, lojërat online tanimë integrojnë mundësinë për të biseduar mes vete me zë apo video, apo për të shkëmbyer informata personale. Fëmijë nga e gjithë bota mund të luajnë së bashku dhe të komunikojnë mes vete përmes ueb faqeve të lojërave. Shumë lojëra online ofrojnë mundësinë që fëmijët të flasin më njëri tjetrit përdoruesit luajnë, duke i ekspozuar ata ndaj rreziqeve të ndryshme. Rreziqet më të shpeshta që hasen nga lojërat online janë sabërdhuna, vjedhja apo keqpërdorimi i informatave personale, dhe joshja. Padyshim që lojërat online janë aktivitete shumë të pëlqyeshme edhe për fëmijët kosovar.

■ **Figura 10:** Fëmijët që luajnë lojëra në internet



Sofistikimi i lojërave online (virtuale) mundëson që lojtarët të mund të bisedojnë me zë, apo edhe të kenë pamje të njëri-tjetrit në kohë reale, e gjitha kjo që loja të jetë sa më atraktive. Sidoqoftë, kjo e rrit edhe mundësinë e ekspozimit ndaj rreziqeve të ndryshme që vijnë nga përdorimi i internetit.

■ **Figura 11:** Çfarë lojëra luajnë fëmijët në internet?



Fëmijët janë pyetur se çfarë lojëra luajnë ata në internet. Siç mund të shihet nga përgjigjet e marra, rreth 66% e fëmijëve luajnë lojëra logjike të cilat ju ndihmojnë që të zhvillojnë mendimin kritik dhe poashtu të ngrisin kapacitetet e tyre logjike. Kjo shifër ka shënuar rritje nga viti 2014 (57%) dhe mund të konsiderohet pozitive. Sidoqoftë, në anën tjetër vërejmë trendin në rritje edhe të fëmijëve që luajnë lojëra luftarake ose agresive, gjë që është mjaft shqetësuese. Rreth 35% e fëmijëve janë përgjigjur se luajnë lojëra luftarake ose agresive (rreth 29% në vitin 2014). Fëmijët që luajnë lojëra të tilla mund të kenë rritje të agresivitetit në sjelljet e tyre dhe poashtu mund të kenë ngarkesa të ndryshme psikike. Lojërat që luajnë mund të kenë efekt të drejtpërdrejtë te fëmijët. Fëmijët që luajnë lojëra logjike mund të kenë rritje në performancën e tyre akademike dhe e kundërta për fëmijët që luajnë lojëra agresive. Rekomandohet që prindërit të jenë të vetëdijshëm se çfarë lojëra luajnë fëmijët e tyre gjatë përdorimit të internetit dhe mjeteve të ndryshme teknologjike. Në këtë mënyrë ata mund të kuptojnë se nga vjen ndryshimi në sjelljet e fëmijëve të tyre.

RREZIQET PËR FËMIJË NGA PËRDORIMI I PA MONITORUAR I INTERNETIT

Interneti ka ndryshuar mënyrën e jetesës dhe ka bërë revolucion sa i përket komunikimit dhe fushave të tjera të jetës. Në ditët e sotme përdorimi i internetit është pothuajse i pashmangshëm: duke filluar nga leximi i informacioneve gjatë ditës, blerjet nëpërmjet internetit, mësimet e ndryshme, ndarja e momenteve me më të dashurit, puna, etj. Ky revolucion teknologjik më së shumti ka ndikuar te moshat e reja që më nuk kanë nevojë të përshtaten në këto ndryshime, por thjesht ata rriten në një ambient ku interneti është mjet pa të cilin jetesa është shumë e vështirë. Sidoqoftë, është faktike se përdorimi i internetit në mënyrë të pasigurt mund të sjell pasoja të mëdha, posaqërisht për moshat e reja. Inkurajimi i përdorimit të internetit në mënyrë të përgjegjshme dhe të sigurt si dhe njohja me rreziqe potenciale janë hapa kyç në krijimin e një platforme për menaxhimin e rrezikut që t'i mbajmë fëmijët të sigurt në internet.

Disa rreziqe të adresuara nga pyetësi ynë, dhe të paraqitura në këtë raport, janë: shikimi i videove me përmbajtje jo adekuate online (p.sh. video që tregojnë përdorim të dhunës nga konflikte dhe luftëra të ndryshme, lojëra agresive, video pornografike, përmbajtje seksuale, etj), takimi me persona të panjohur, sajberdhuna, keqpërdorimi i të dhënave personale dhe sulmi nga viruset.

Përmbajtja e materialeve të papërshtatshme në internet


Problem i theksuar për fëmijët gjatë përdorimit të internetit është se shpeshherë ata mund të hasin në përmbajtje të papërshtatshme të uebfaqeve të ndryshme. Ka shumë uebfaqe që përmbajtja e tyre është ilegale, por poashtu problemi qëndron edhe me uebfaqe të tjera materialet e të cilave janë legale por se janë të dedikuara vetëm për të rritur dhe nuk ka mekanizëm ndalues që fëmijët të mos mund të qasen në këto uebfaqe. Fëmijët mund të kenë qasje në përmbajtjet pornografike rastësisht ose qëllimisht nga kurioziteti.

Për shkak të sensitivitetit të temës në pyetësin e zhvilluar nuk ka pasur mundësi që pyetjet për pornografinë t'i formulojmë në formë eksplicite, që të mos iu tërheqim vëmendjen për një fenomen me të cilin fëmijët mund edhe të mos jenë të njohur. Për këtë arsye, pyetjet në lidhje me përmbajtje seksuale nuk kanë qenë të përfshira në anketën e bërë për fëmijët nën moshën 12 vjeçare. Pyetjet në lidhje me përmbajtjet seksuale për fëmijët 12-15 vjeç kanë qenë të paraqitura në këtë mënyrë:

“Në 12 muajt e kaluar ju mund të keni parë pamje të ndryshme në internet – fotografi, video, etj. Shpeshherë këto pamje kanë përmbajtje të papëlqyeshme (pornografike). Ju ndoshta NUK keni parë diçka të këtyllë, ose KENI parë diçka të këtyllë: p.sh. në telefonin mobil, në kompjuter, në TV, etj.

A keni pa DIÇKA të ngjashme në 12 MUAJT e kaluar? (p.sh. Foto ose video të papërshtatshme (p.sh. pornografike))”

Figura 12: Fëmijët kanë parë imazhe me përmbajtje të papërshtatshme




Bazuar në përgjigjet e fëmijëve, vërehet një rënie e trendit të shikimit të përmbajtjeve të papërshtatshme në mes të vitit 2014 dhe 2016. Sido që të jetë, në vitin 2016 rreth 26% e fëmijëve kanë deklaruar se kanë shikuar përmbajtje të papërshtatshme, krahasuar me 38% në 2014. Poashtu ka rënie edhe sa i përket shpeshësisë së shikimit të përmbajtjeve pornografike. Në 2016, 15% e fëmijëve kanë shikuar përmbajtje pornografike të pakten një herë në javë, krahasuar me 41% në 2014. Duhet të theksohet që pyetja rreth përmbajtjes pornografike është drejtuar vetëm për fëmijët 12-15 vjeç.

Në aspektin e gjinisë mund të vërehet dallim i rendësishëm; rreth 64.4% i përkasin gjinisë mashkullore, kurse 35.6% gjinisë femërore. Ekspozimi ndaj materialeve me përmbajtje të papërshtatshme në internet është treguar te fëmijët e këtyre komunave si në vijim: Prizren (42%), Ferizaj (27%), Pejë (25%), Mitrovicë (24%), Prishtinë (24%), Gjakovë (22%) dhe Gjilan (21%).

Shikimi i videove me përmbajtje pornografike në internet mund të mos ketë ndikim të njejtë te secili fëmijë. Varësisht nga fëmija, shikimi i këtyre videove mund të ketë ose të mos ketë ndonjë ndikim pozitiv apo negativ. Për këtë arsye i kemi pyetur të gjithë fëmijët që kanë parë video me përmbajtje pornografike, nëse ata janë shqetësuar nga ato pamje. Pyetja ishte formuluar si në vijim:

“Të shohësh fotografi të papëlqyeshme (pornografike) në internet mund të jetë në rregull ose jo në rregull. Në 12 muajt e fundit, a keni parë ndonjë gjë të këtyllë që ju ka shqetësuar juve në ndonjë mënyrë? Për shembull, ju ka bërë të pendoheni, të mërzitemi apo keni menduar se nuk është dashur t'i shikoni ato.”

■ **Figura 13:** A janë shqetësuar fëmijët nga shikimi i imazheve me përmbajtje të papërshtatshme gjatë 12 muajve të fundit?



Vërehet se ka rënie në numrin e fëmijëve që kanë qenë të shqetësuar kur shikojnë përmbajtje pornografike (nga 42% në vitin 2014, në 38% në vitin 2016). Sidoqoftë, në krahasimin e shqetësimit ndërmjet gjinive vërehet se trendi është përafërsisht i njëjtë (rreth 3-5% dallim). Në vitin 2014, rreth 45% e vajzave kanë qenë të shqetësuar me shikimin e videove të papërshtatshme, në krahasim me djemtë 40%. Në 2016 te vajzat ka rënie të shqetësimit në 40%, kurse te gjinia mashkullore rreth 37%.

Sipas rezultateve nga përgjigjet e fëmijëve, 96% e fëmijëve që shohin pamje të papërshtatshme (psh. pornografike) janë fëmijët që kanë telefon të mençur personal. Siç dihet, monitorimi i fëmijëve gjatë përdorimit të internetit është mjaft i vështirë në cilëndo pajisje, por posaçërisht gjatë përdorimit të telefonit mobil për shkak të madhësisë që ai ka, dhe poashtu mundësisë për të lëvizur nga një vend në një vend tjetër.

Nga përgjigjet e fëmijëve ka dalë që fëmijët që e përdorin internetin 'në shtëpi në dhomë të ndejës' shikojnë më shumë përmbajtje të papërshtatshme (për rreth 26%) krahasuar me ata që nuk kanë qasje në internet në dhomë të ndejës. Në këtë mënyrë kemi sinjal se shikimi i materialeve me përmbajtje ilegale mund të behet nga fëmijët edhe nëse prindi është në të njëjtën hapësirë me fëmijën.

Përqindje e lartë e fëmijëve që shikojnë përmbajtje të papërshtatshme i përket kategorisë që lidhen në internet në shtëpi të shokut – rreth 36%.

Në përgjithësi, kur fëmijët përdorin internetin në vendet publike apo në kompjuterë të përbashkët siç janë shkollat apo në internet kafe, është më e vështirë që të kenë qasje në përmbajtje të papërshtatshme. Nga ana tjetër, rreziku është më i lartë kur ata kanë qasje të pamonitoruar, sikurse është rasti, shumicën e kohës, me përdorimin e telefonave mobil.

Përdorimi i internetit nga fëmijët në Kosovë është shumë i personalizuar dhe në këtë mënyrë qasja dhe përdorimi i internetit është shumë vështirë të monitorohet nga mësuesit dhe prindërit. Përdorimi i pajisjeve personale siç janë telefonat mobil, apo kompjuterët dhe laptopët personal, vërteton se fëmijët mund ta bëjnë dallimin ndërmjet përmbajtjeve adekuate dhe jo adekuate, pasi që për të shikuar përmbajtje të papërshtatshme ata përdorin më shumë pajisje personale (të cilat janë më të vështira të monitorohen).

Takimi me njerëz të panjohur

Ka shumë shqetësime që përcillen te të rriturit për faktin se fëmijët përdorin internetin në mënyrë të pasigurt. Infektimi me viruse të ndryshme, keqpërdorimi i të dhënave personale, shikimi i materialeve me përmbajtje të papërshtatshme, etj. janë vetëm disa nga shqetësimet që të rriturit kanë për fëmijët. Shqetësimi më i madh qëndron te bisedat që fëmijët bëjnë me të panjohurit online, dhe rrezikun eventual që fëmijët mund të takojnë dikë online, i cili pastaj mund t'i abuzojë në takim ballë për ballë. Studime të ndryshme gjatë viteve tregojnë se forumet online janë target i keqbërësëve dhe pedofilëve në mënyrë që ata të bijnë në kontakt me persona të moshave të reja.

Rrjetet sociale ofrojnë komunikim virtual i cili lehtë mund të keqpërdoret nga të rriturit dhe mund të nxisë apo ndihmojë keqbërësit që të ngacmojnë fëmijët, duke lënë kështu pasoja serioze te fëmijët.


Fillimisht, pyetësi ka synuar që të kuptojë se sa është numri i fëmijëve që kontaktojnë në internet me njerëz që nuk i kanë takuar më parë. Pyetja është shtruar si në vijim:

"A keni pasur ndonjëherë kontakt nëpërmjet internetit me dikë që nuk e keni takuar më parë personalisht?"

Shumica nga fëmijët që e përdorin internetin dhe rrjetet sociale kanë kontakt të vazhdueshëm me njerëzit që i njohin nga jeta e përditshme. Sidoqoftë, numri i fëmijëve të cilët kanë kontakt nëpërmjet internetit me dikë që nuk e njohin personalisht është tejet i madh. Nga përgjigjet e marra ka rezultuar se 43% e fëmijëve kontaktojnë nëpërmjet internetit me njerëz që nuk i kanë njohur personalisht.


Më tutje, shqetësimi qëndron në pjesën nëse fëmijët kanë takuar ndonjëherë personalisht këta persona që kontaktin fillestar e kanë pasur nga interneti. Në mesatare 61% e fëmijëve kanë pranuar se kontaktojnë nëpërmjet internetit me persona që nuk i kanë njohur personalisht. Pikërisht kjo është faza në të cilën shqetësimi është i madh. Takimi ballë për ballë i fëmijëve me njerëz të panjohur paraqet rreziqe të jashtëzakonshme sikurse janë shqetësimi, abuzimi seksual me fëmijët, dhuna fizike, trafikimi i fëmijëve, etj.

■ **Figura 14:** Fëmija është takuar me dikë të panjohur të cilin për herë të parë e ka kontaktuar nëpërmjet internetit




Në aspektin e gjinisë, rreth 67% e djemve kanë raportuar se kanë takuar dikë personalisht të cilin për herë të parë e kanë kontaktuar nëpërmjet internetit, kurse te gjinia femërore kjo shifër është rreth 53%. Është evidente se sa më të rinjë të jenë fëmijët që takojnë njerëz të panjohur të cilët i njohin vetëm nëpërmjet internetit, aq më i lartë është edhe rreziku. Siç shihet në grafikun më lart, rreth 68% e fëmijëve të moshave 9-12 vjeç kanë takuar dikë personalisht të cilin për herë të parë e kanë kontaktuar nëpërmjet internetit, kurse te moshat 13-16 vjeç kjo shifër është rreth 54%.

Figura 15: Numri i njerëzve të panjohur që fëmijët i kanë takuar ballë për ballë




Për të zbuluar më shumë lidhur me eksperiencën e fëmijëve të cilët janë takuar me njerëz të panjohur, fëmijët i kemi pyetur se sa njerëz kanë takuar në këtë mënyrë. Për shkak të interpretimit sa më të saktë të kësaj statistike, është e rëndësishme të shpjegohet se kjo pyetje përfshinë vetëm fëmijët që kanë raportuar se janë takuar me njerëz të panjohur nga interneti. Bazuar në grafikun më lart shohim se shumica e fëmijëve (38%) kanë takuar 1-2 persona që së pari i kanë njohur nëpërmjet internetit. Ky numër ka shënuar rënie në krahasim me vitin 2014 ku kjo shifër ishte 44%. Poashtu, mund të vërehet se një shifër mjaftë e lartë e fëmijëve (rreth 24%) kanë zgjedhur opsionin “nuk e di”.

Figura 16: Numri i personave të panjohur që fëmijët kanë takuar dhe janë shqetësuar nga ky takim



Fëmijët të cilët janë përgjegjës se kanë takuar ndonjëherë dikë personalisht, të cilin për herë të parë e kanë kontaktuar nëpërmjet internetit, janë pyetur se a janë shqetësuar nga këto takime. Në total, rreth 32% e fëmijëve janë përgjigjur se janë shqetësuar nga takimet që i kanë pasur me këta persona të panjohur. Shumica e fëmijëve (37%) janë përgjigjur se janë shqetësuar nga 1-2 persona. Sidoqoftë, është shqetësuese rritja prej 14% (viti 2014) në 19% (viti 2016) e fëmijëve që janë shqetësuar nga 3-4 persona. Nga shifrat më lart, poashtu mund të shohim se 17% i fëmijëve janë shqetësuar nga më shumë se 10 persona. Nga kjo rezulton se për një numër të fëmijëve, takimet me persona të cilët i kanë njohur vetëm nëpërmjet internetit janë të shpeshta, pa marrë parasysh se shpeshherë ndodh që ata të shqetësohen gjatë apo pas takimit.

Figura 17: Moshat e personave të panjohur që fëmijët kanë takuar dhe janë shqetësuar nga ky takim



Nga fëmijët të cilët kanë takuar njerëz të panjohur dhe kanë qenë të shqetësuar nga këto takime, rreth 63% e tyre janë takuar me dikë të moshës së tyre. Nga grafiku më lart, shihet se shumica e takimeve bëhen me bashkëmoshatarë. Nëse krahasojmë rrezikun që të rinjtë kanë kur takohen me dikë të cilin për herë të parë e kanë njohur nëpërmjet internetit, rreziku është shumë më i ulët kur ata takohen me bashkëmoshatarë se sa me njerëz më të moshuar. Poashtu, nëse e krahasojmë me vitin 2014, shohim se ka rritje prej 10% në 24% të fëmijëve të cilët zgjedhin opsionin “Nuk e di”, duke lënë dilema se cila mund të jetë moshë e personave me të cilët ata janë takuar dhe kanë pasur shqetësim nga ky takim.

Të gjeturat nga pyetësi dëshmojnë se 9% e fëmijëve që kanë qenë të shqetësuar nga takimi me njerëz të panjohur takohen me njerëz më të vjetër dhe 5% e tyre takohen me njerëz më të vjetër se 20 vjeç. Mundësia e rrezikut të dëmit fizik dhe psikologjik është më e madhe për fëmijët të cilët takohen me fëmijët të cilët janë më të mëdhenj se ata, madje edhe më e madhe kur takohen me të rriturit. Pasojat që takimet me të panjohur mund të kenë te fëmijët, duhet të ekzamino-hen me kujdes nga shoqëria dhe nevojiten politika reaktive dhe pro-aktive për të adresuar këtë çështje problematike.

Rreziqet tjera

Paraprakisht kemi shpjeguar disa nga rreziqet që paraqiten gjatë përdorimit të internetit, si: shikimi i videove me përmbajtje pornografike, video-lojërat dhe takimet me njerëz të rinj. Vlen të përmendet se ky është një problem global, dhe theksohet pothuajse në të gjitha raportet botërore lidhur me sigurinë në internet. Në vijim do të vazhdojmë të flasim edhe për disa rreziqe të tjera që fëmijët mund të hasin gjatë përdorimit të internetit, si: publikimi i të dhënave personale dhe keqpërdorimi i tyre.


Publikimi i të dhënave personale

Janë faktorë të ndryshëm të cilët ndikojnë në ekspozimin e fëmijëve ndaj rreziqeve të ndryshme në internet. Njëri nga këta faktorë është edhe shpalosja e aktiviteteve të fëmijëve apo mos kontrollimi i parametrave të privatësisë nëpër rrjete sociale apo adresa elektronike. Duke pasur parasysh se rrjetet e ndryshme sociale ofrojnë mundësi për shfaqjen e të dhënave personale, ky hulumtim ka për synim që të kuptojë se sa i kufizojnë fëmijët Kosovarë informatat e tyre personale gjatë përdorimit të internetit.

Nga të gjeturat e hulumtimit mund të kuptohet se fëmijët në një masë të madhe publikojnë të dhëna personale (fotografi, e-mail adresën, emrin e shkollës) gjatë përdorimit të rrjeteve sociale. Në mënyrë që të kemi një pasqyrë se çka saktësisht postojnë fëmijët gjatë përdorimit të rrjeteve sociale ata janë pyetur:

“Cilat nga këto informata i publikoni (vendosni) në profilin tuaj?”

■ **Figura 18:** Të dhënat personale të cilat fëmijët i postojnë në internet



Në grafikun më lart mund të shohim se 91% e fëmijëve postojnë fotografite e tyre personale në rrjetet sociale. Poashtu, rreth 38% e fëmijëve Kosovarë tregojnë se në cilën shkollë vijnë mësimet. Krahasuar me 2014 postimi i emrit të shkollës ka rënie nga 67% në 38%, që mund të shihet si trend pozitiv dhe poashtu vetëdijësim i fëmijëve prej rreziqeve që u kanosen nga postimi i këtij informacioni.

Shihet se rreth 10% e fëmijëve postojnë edhe numrin personal të telefonit në rrjete sociale. Rreth 79% e fëmijëve që janë përgjigjur se postojnë numrin e telefonit në rrjete sociale i përkasin gjinisë mashkullore.


Keqpërdorimi i të dhënave personale

Gjatë përdorimit të internetit fëmijët ballafaqohen me probleme të ndryshme si: sulmi nga viruse të ndryshme, keqpërdorimi i të dhënave personale, ofendimet dhe kërcënimet, vjedhja e fjalëkalimeve etj. Këto janë disa nga problemet që fëmijët Kosovarë i hasin.

Njësoj si në hulumtimin e vitit 2014, edhe kësaj rradhe hulumtimi synon që të kuptohet nëse fëmijës i ka ndodhur njëra nga këto ndodhi: kompjuteri i fëmijës është sulmuar nga viruset; të dhënat personale janë keqpërdorur; fëmijës i është vjedhur fjalëkalimi; dikush ka postuar përmbajtje të pakëndshme në murin e fëmijës; fëmija ka qenë i ofenduar, ngacmuar, ose kërcënuar.

Rezultatet nga kjo pyetje janë si në vijim:

■ **Figura 19:** Fëmijët që kanë hasur në probleme të ndryshme gjatë përdorimit të internetit në vitin e fundit (në përqindje)



Rezultatet tregojnë një ulje në sulmin e viruseve që fëmijët kanë pasur në kompjuterin e tyre (prej 55% në 36%). Viruset në kompjuter ndikojnë në sigurinë dhe privatësinë e fëmijëve në internet. Vërehet se sulmet nga viruset janë përafërsisht të njëjta si te gjinia mashkullore dhe ajo femërore (53% meshkuj, 47% femra).

Në figurën më lart mund të shohim se 7.6% e fëmijëve kanë raportuar se të dhënat e tyre personale janë keqpërdorur, rreth 61% e këtyre fëmijëve i përkasin gjinisë mashkullore. Rreth 17% e fëmijëve kanë deklaruar se dikush ua ka vjedhur fjalëkalimin e e-mailit personal, ndërsa 5% deklaruan se dikush u ka postuar përmbajtje të papëlqyeshme në murin e tyre në rrjetet sociale. Ajo që mund të vërehet është se ka rënie nga viti 2014 në të gjitha rreziqet në figurën më lart.

Përkundër faktit që shohim një përqindje relativisht të ulët e fëmijëve që kanë raportuar se kanë qenë të kërcënuar nëpërmjet internetit ose që janë ndier në rrezik gjatë vitit të fundit, në numër shohim se janë rreth 83 fëmijë që kanë përjetuar këtë, edhe kjo është mjaft shqetësuese. Teknologjia dhe interneti ju kanë dhënë fëmijëve një platformë krejtësisht të re komunikimi dhe si rrjedhojë ka rritur nivelin e ekspozimit të tyre kundrejt mesazheve dhe teksteve kërcënuese, që kanë ndikim negativ tek shëndeti i tyre.

SAJBËRDHUNA (DHUNA NËPËRMJET TEKNOLOGJISË)

Sajbërdhuna është përdorimi i qëllimshëm dhe i përsëritur i mjeteve elektronike (si psh. internetit apo telefonit mobil) për të ngacmuar, kërcënuar, poshtëruar, turpëruar një apo më shumë persona. Sajbërdhuna ushtrohet te të gjitha grupmoshat, pasojat janë më të mëdha për moshat e reja, pasi që fëmijët janë më të ndjeshëm se sa te rriturit.

Disa nga veprimet e ndërmarra nga personat që ushtrojnë sajbërdhunë janë: postimi i thashethemeve në internet për një person të caktuar, kërcënime të llojeve të ndryshme, krijimi i profileve të rreme etj. Avansimi i teknologjisë dhe rritja e përdorimit të rrjeteve sociale, te të rinjtë poash-tu rrit edhe mundësinë e personave që ushtrojnë sajbërdhunë. Vlen të theksohet se sajbërdhuna shihet si një ndër problemet globale që kanë ndikim negativ te fëmijët.

Sajbërdhuna përshkruhet si dhimbje virtuale, por dhimbja dhe pasojat janë reale. Mënyrat se si fëmijët ngacmohen nëpërmjet internetit mund të ketë ndikim të madh në psikologjinë e tyre. Mungesa e mbikëqyrjes së forumeve elektronike nga autoritetet shtetërore, prindërit ose mësuesit, iu mundëson ngacmuesve t'i kenë në shënjestër dhe t'i kontaktojnë viktimat e tyre më lehtë dhe më shpesh.

Liria e shprehjes është e garantuar për të gjithë, mirëpo shpesh uebfaqet e tilla ngacmojnë në vazhdimësi një fëmijë apo grupe të caktuara fëmijësh. Një sulm i tillë bëhet barrë për individët e sulmuar, duke iu pamundësuar funksionim normal të jetës së tyre.

Identifikimi i sajbërdhunës

Fjala sajbërdhunë është përkthim i përshtatur nga fjala “cyber-bullying” në gjuhën angleze. Pasi që për “cyber” nuk ka përkthim adekuat, edhe sajbërdhuna përkufizohet me shumë terme si: keqtrajtimi, ofendimi dhe zemërimi etj., nëpërmjet internetit. Në shumë raste është e vështirë nga fëmijët të kuptohet se çfarë saktësisht është sajbërdhuna. Për këtë arsye në pyetësinë për hulumtim, ne kemi ofruar informata shtesë në mënyrë që sajbërdhuna të kuptohet saktësisht nga personat që marrin pjesë në hulumtim. Paragrafi në vijim është pjesë e pyetësorit si informatë shtesë për fëmijët:


“Shpeshherë fëmijët ose adoleshentet thonë ose bëjnë gjëra të dëmshme ose të pakëndshme ndaj dikujt tjetër.

Kur njerëzit veprojnë kështu me dikë, këtë mund ta bëjnë në disa mënyra:

- ballë për ballë (personalisht),
- nëpërmjet telefonit mobil (mesazheve, thirrjeve, videove) apo
- nëpërmjet internetit (e-mailave, mesazheve elektronike, rrjeteve sociale, chate-ve)”.

Kështu, fëmijët janë pyetur nëse dikush ka ushtruar sjambërdhunë ndaj tyre në 12 muajt e fundit. Përgjigjet në këtë pyetje janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm.

Figura 20: Ngacmimet e fëmijëve nëpërmjet internetit ose ndonjë mënyre tjetër në 2016 dhe 2014



Në bazë të përgjigjeve, në total mund të shohim se përqindja e sjambërdhunës te të rinjtë nuk ka shumë dallim në vitet 2014-2016. Sidoqoftë, dallim i mjaftueshëm mund të shihet në grupmoshat që janë viktimë e sjambërdhunës. Në vitin 2014 vetëm 21% e fëmijëve 13-16 vjeç janë përgjegjur se kanë qenë viktimë e sjambërdhunës krahasuar me vitin 2016 ku kjo shifër është rritur në 30%. Rreth 56% e fëmijëve që janë përgjegjur se kanë qenë viktimë e sjambërdhunës i përkasin gjinisë mashkullore.

Hulumtimi ka për synim që të kuptohet se sa shpesh fëmijët janë viktimë e dhunës nëpërmjet internetit. Rreth 9% e fëmijëve kanë treguar se përballën me këto probleme çdo ditë ose pothuajse çdo ditë. Rreth 7% e fëmijëve kanë pohuar se kanë përjetuar sjambërdhunë një ose dy herë në javë.

Tabela 2: Sa shpesh është ngacmuar fëmija në vitin e fundit? (në përqindje %)


	Gjinia		Moshë		Total
	Mashkull	Femër	9 - 12 vjeç	13 - 16 vjeç	
Çdo ditë ose pothuajse çdo ditë	7.6	9.9	10.8	5.5	8.6
Një ose dy herë në javë	8.5	5.0	7.0	7.2	6.9
Një ose dy herë në muaj	10.0	10.6	9.7	11.1	10.2
Më rrallë	45.5	39.8	41.1	44.8	42.9
Nuk e di	28.4	34.8	31.4	31.5	31.4

Bazuar në tabelën më lart, mund të shohim se shumica (42.9%) e fëmijëve kanë treguar se ngacmohen më rrallë se një herë në muaj. Vlen të theksohet se fëmijët mund të jenë viktimë të sjambërdhunës vetëm një herë, dhe kjo të mjaftojë që ata të kenë pasoja afatgjate. Sjambërdhuna është edhe një nga arsyet pse fëmijët nganjëherë kanë nota më të dobëta në mësimet (presion psikik dhe mungesë të vëmendjes); pse ata e braktisin shkollën; dhe poashtu një nga arsyet pse kanë probleme me shëndetin.

Format e sjambërdhunës

Në mënyrë që të kemi një pasqyrë sa më të plotë rreth sjambërdhunës, fëmijët janë pyetur që të tregojnë se në çfarë forme ata kanë qenë viktimë e sjambërdhunës.

Figura 21: Mënyrat se si janë ngacmuar fëmijët nëpërmjet internetit




Përqindja e fëmijëve që kanë qenë viktimë e sjambërdhunës nëpërmjet rrjeteve sociale ka shënuar rritje nga 53% në 61% (viti 2014-2016). Rreth 57% e fëmijëve që e përjetojnë sjambërdhunën nëpërmjet rrjeteve sociale janë meshkuj. Më tutje, mund të shihet se rritje ka edhe në sjambërdhunën që vjen përmes mesazheve në internet, nga 35% në 41%. Poashtu vërehet se rritje në sjambërdhunë ka edhe nëpërmjet çatit (mesengerit), ueb-faqeve të lojërave dhe thirrjeve në telefon me mesazhe apo video. Pasiqë rrjetet e ndryshme sociale japin mundësinë për të postuar fotografi të ndryshme, të dhëna personale dhe postime të tjera, është e kuptueshme që rrjetet sociale të përdoren më shumë nga personat që ushtrorjnë sjambërdhunë.

Si përballen moshat e reja me sjambërdhunën

Është e kuptueshme se secila formë e sjambërdhunës mund të ketë efekt të ndryshëm në jetën e fëmijëve. Disa fëmijë mund të shqetësohen më shumë e disa më pak nga format e ndryshme të sjambërdhunës. Hulumtimi synon që të kuptojë përballjen e fëmijëve me këtë fenomen. Për këtë arsye ne i kemi pyetur fëmijët drejtpërdrejt se sa kanë qenë ata të shqetësuar nga hera e fundit që kanë qenë viktimë e sjambërdhunës.

■ **Figura 22:** Fëmija ka qenë i shqetësuar nga ngacmimi në internet



Rreth 22% e fëmijëve kanë deklaruar se kanë qenë shumë të shqetësuar kur ndaj tyre është ushtruar sjambërdhunë. Rreth 32% prej tyre janë femra, kurse 14% janë meshkuj. Ky numër ka shënuar rënie në krahasim me vitin 2014, kur këto përqindje ishin respektivisht 43% dhe 29%. Meshkujt që kanë deklaruar se nuk janë shqetësuar aspak, nga hera e fundit kur kanë qenë viktimë e sjambërdhunës, janë rreth 44% krahasuar me vitin 2014 kur kjo shifër ishte 31%.


Është e rëndësishme të dihet se cilat janë hapat që fëmijët ndërmarrin kur ndaj tyre ushtrohet sjambërdhunë. Hulumtimi përfshinë pyetje në të cilat fëmijët kanë mundësi që të tregojnë disa nga hapat që ata i ndërmarrin kur ballafaqohen me sjambërdhunën. Rreth 37% e fëmijëve që kanë përjetuar sjambërdhunë, kanë ndaluar përdorimin e internetit për një kohë. Kjo përqindje ka shënuar rritje në krahasim me vitin 2014 ku kjo shifër ishte 28%. Më tutje mund të shihet se rreth 50% e fëmijëve që përjetojnë, fshijnë të gjitha mesazhet nga personi që ushtron sjambërdhunë ndaj tyre. Njëra nga arsyet pse fëmijët marrin hapa të tillë është se ata nuk dëshirojnë që të shohin sërish sjambërdhunën me të cilën janë përballur. Sidoqoftë, vlen të theksohet se fëmijët inkurajohen që gjithmonë të ruajnë provat/dëshmitë dhe poashtu të njejtat t'i ndajnë me prindërit. Poashtu ka rritje prej 15% në 19% në përqindjen e fëmijëve që marrin masa në ndryshimin e parametrave të privatësisë në rrjete sociale. Vërehet se hapi që fëmijët ndërmarrin më së shumti është bllokimi i personit i cili ka ushtruar sjambërdhunë ndaj tyre. Sidoqoftë, format e ndryshme të sjambërdhunës mundësojnë që edhe nëse është bllokuar ngacmuesi, mesazhi ofendues veç është shpërndarë në internet dhe bllokimi jo domosdoshmërisht do të ndal ose fshij mesazhin.

■ **Tabela 3:** Çfarë ka bërë fëmija pasi ka qenë i ngacmuar nëpërmjet internetit?

	Frekuenca	Përqindja
Kam ndaluar përdorimin e internetit për një kohë	94	36.7
Kam fshirë çdo mesazh nga personi në fjalë	135	50.4
Kam ndryshuar parametrat e privatësisë	44	19.4
E kam bllokuar personin që të më kontaktoj	163	61.3
E kam raportuar problemin	64	27.8
I kam ruajtur provat	9	34.6
Asnjërin nga këto gjëra	67	27.7
Nuk e di	17	8.0
	593	-

Në momentin që fëmija është viktimë e sjambërdhunës është tejet e rëndësishme që ai këtë barër mos ta mbaj mbi vete, por të bisedoj me personin të i cili mund të gjejë mbështetje. Gjatë plotësimit të pyetësorit fëmijët kanë pasur mundësinë të tregojnë se me kë kanë biseduar pas ballafaqimit me sjambërdhunën.

■ **Figura 23:** Me kënd ka biseduar fëmija pasi ka qenë i ngacmuar në internet?




Bazuar në figurën më lart, shihet se përqindja më e madhe e fëmijëve (68%) preferojnë që të flasim me shokun/shoqen për ballafaqimin e tyre me sjambërdhunën. Vërehet poashtu se fëmijët preferojnë të bashkëbisedojnë edhe me prindërit. Si në vitin 2014, poashtu edhe në 2016 vërehet përqindje relativisht e ulët e fëmijëve që preferojnë të ndajnë përvojat e tyre të vështira më mësuesin. Mësuesin duhet krijuar lidhje me fëmijën, që ai të ndihet i sigurt të diskutojë haptazi shqetësimet e tij më mësuesin.

Efektet e sajberdhunës

Efektet e sajberdhunës mund të jenë afatgjate dhe t'i përcjellin fëmijët gjatë gjithë jetës. Njëra nga arsyet pse sajberdhuna mund të lëndojë fëmijët më shumë se dhuna fizike vjen prej audiencës së madhe që ajo mund të arrijë për një kohë mjaft të shkurtë. Reagimet më të shpeshta nga fëmijët, që janë prekur nga sajberdhuna, janë zemërimi, frika, hidhërimi, shqetësimi dhe të ndjenit i/e lënduar.

Për të kuptuar se sa mund të ndikojnë tek fëmija llojet e ndryshme të sajberdhunës, ne kemi pyetur fëmijët se a shpenzojnë shumë kohë duke biseduar me shokët e tyre për atë se çfarë ndodh në internet apo në rrjetet sociale dhe poashtu a ndodh që fëmijët të përleshën me shokët e klasës për shkak të ndodhive në internet.

■ **Figura 24:** Reagimi i fëmijëve nga përmbajtja në internet



Bazuar në përgjigjet e fëmijëve mund të shohim se 34% e tyre diskutojnë me shokët e klasës për atë që ndodh në internet. Më tutje, rreth 18% e fëmijëve kanë pasur përleshje me shokët e klasës për diçka që ka ndodhur gjatë përdorimit të internetit.

■ **Tabela 4:** Karakteristikat shoqërore dhe psikologjike të fëmijëve 2016 (në përqindje %).

Viti 2016	Jo e vërtetë	E vërtetë	Shumë e vërtetë
Kam se paku një shok të mirë	23	15	62
Shpesh jam i/e mërziur, trishtuar ose i/e përlotur	57	31	12
Moshatarëve të mi në përgjithësi ju pëlqej	16	28	56
Shpesh me akuzojnë për gënjeshtër ose mashtrim	79	15	6
Moshatarët e mi shpesh më trajtojnë sikur të mos isha aty	82	12	5
Kaloj më mirë me të rritur sesa me moshatarët e mi	61	24	16
Kam frikë nga gjëra të shumta, frikohem lehtë	58	28	15

Si përfundim i kemi pyetur të tregojnë se sa të vërteta janë për pyetjet në tabelen më lart. Përgjigjet janë mjaft shqetësuese: 23% e fëmijëve kanë deklaruar se nuk kanë asnjë shok, 31% ngan-

jëherë ndihen të trishtuar dhe të mërziur, 16% kanë deklaruar se shoqëria e tyre nuk e pëlqejnë atë, përderisa 28% kanë raportuar se ata nganjëherë ndjehen të frikësuar. Vlen të theksohet se këto përqindje janë të përafërta me ato të vitit 2014 (shih figurën më poshtë).

■ **Tabela 5:** Karakteristikat shoqërore dhe psikologjike të fëmijëve 2014 (në përqindje %).

Viti 2014	Jo e vërtetë	E vërtetë	Shumë e vërtetë
Kam se paku një shok të mirë	22	16	62
Shpesh jam i/e mërziur, trishtuar ose i/e përlotur	48	39	13
Moshatarëve të mi në përgjithësi ju pëlqej	19	31	49
Shpesh me akuzojnë për gënjeshtër ose mashtrim	69	20	10
Moshatarët e mi shpesh më trajtojnë sikur të mos isha aty	72	20	8
Kaloj më mirë me të rritur sesa me moshatarët e mi	58	27	16
Kam frikë nga gjëra të shumta, frikohem lehtë	60	28	12

Këto pyetje janë ngritur në mënyrë që të kuptojmë se si ndjehen fëmijët dhe t'i informojmë politikë-bërësit, prindërit dhe mësuesit lidhur me këtë.

REKOMANDIME

Fëmijët dhe të rinjtë

Fëmijët dhe të rinjtë duhet inkurajuar për:

- të mbështetur njëri-tjetrin duke ndarë informacione në lidhje me njohuritë që i kanë për mënyrat e sigurta të përdorimit të internetit;
- të qenë përgjegjës për sjelljen dhe veprimet e tyre në internet;
- të respektojnë shërbimet online, duke iu përshtatur shërbimeve dhe përmbajtjes që është e lejuar për moshën e tyre e për të kërkuar këshilla nga prindërit dhe mësuesit nëse është e nevojshme;
- të raportuar ngacmimet dhe dhunën psikologjike në internet dhe për të bllokuar personat e padëshiruar;
- të kërkuar ndihmë nga prindi, apo dikush tjetër i rritur i besuar, në qoftë se ata ose shokët e tyre janë keqtrajtuar në çfarë do forme në internet;
- të pasur kujdes ruajtjen e privatësisë së tyre dhe të tjerëve në internet, asnjëherë të mos publikojnë të dhëna të tjerëve, duke përfshirë fotografi, video etj. pa pëlqimin e personave që janë përfshirë në këto të dhëna;
- të zgjeruar aftësitë e tyre digjitale nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme në mënyrë që të shfrytëzojnë në maksimum përfitimet që ofron interneti në zhvillimin e tyre edukativ, profesional dhe krijues.

Të fuqizohet përdorimi i internetit nga fëmijët e jo të kufizohet, sepse kufizimi është bërë gati i pamundur me qasjen në internet nëpërmjet telefonave të mençur. Fokusi të përqendrohet në rritje të ndërgjegjësimit, duke nxitur ndjenjën e vetëpërgjegjësisë të fëmijët. Prandaj, interneti duhet të jetë një vend ku ata mund të ndjehen të sigurt për të jetuar jetën e tyre, duke pasqyruar parasysh që sot për shumicën e fëmijëve është e pa imagjinueshme jeta pa internet.

Prindërit duhet të komunikojnë sa më shumë me fëmijët e tyre në lidhje me sigurinë në internet, në mënyrë që fëmijët të kuptojnë rreziqet me të cilat mund të përballen online dhe të kenë informacione se çfarë duhet të bëjnë nëse ata gjenden në telashe në internet. Prindërit poashtu duhet të mbështesin fëmijët e tyre që gjatë kërkimit në internet të fokusohen sa më shumë në aktivitete të ndryshme edukative, argëtuese dhe përmbajtes pozitive në mënyrë që fëmijët të fitojnë sa më shumë shkathhtësi digjitale. Kjo më së miri arrihet kur vet prindërit janë model i përdorimit të mirëfillt të internetit.

Prindërit, bashkarisht me fëmijët e tyre, duhet t'i përcaktojnë rregullat e përdorimit të internetit nga ana e fëmijëve.

Mësimdhënësit/edukatorët – nëpërmjet literaturës dhe trajnimeve të cilat duhet ofruar nga MASHT, duhet të përgatiten sa më shumë në zhvillimin e aftësive të tyre digjitale dhe veçanërisht të jenë sa më të përgatitur në ndërgjegjësimin e fëmijëve për sigurinë dhe rreziqet në internet. Njëherit mësimdhënësit duhet të përkrahin përdorimin e teknologjisë dhe internetit në mënyrë pozitive dhe të dobishme për fëmijët.

Takimi me njerëz - të cilët për herë të parë i kanë takuar/njohur nëpërmjet internetit, paraqet një rrezik serioz për fëmijët. Fëmijët duhet të njoftohen lidhur me rreziqet e mundshme nga takimet e tilla. Prindërit dhe mësimdhënësit të marrin më shumë përgjegjësi në këtë aspekt.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) – të sigurojë trajnime për mësuesit dhe t'ju ofrojë atyre materiale (literaturë) për të ndihmuar fëmijët të ngrisin kapacitetet për vetëmbrojtje nga rreziqet në internet. MASHT duhet të iniciojë bashkëpunimin në mes të prindërve, mësuesve, fëmijëve, industrisë dhe shoqërisë civile për krijimin e kushteve më të favorshme për përdorimin më të sigurt të internetit.

Qeveria – duhet të sponsorizojë më shumë hulumtime rreth përdorimit të internetit, sigurisë online dhe rreziqeve që lidhen me përdorimin e internetit, në mënyrë që të përfshihen edhe mendimet e të rinjve në programet shtetërore që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijëve. Qeveria është përgjegjëse për kornizën ligjore dhe rregullative sa i përket mbrojtjes së fëmijëve, përmbajtjeve ilegale në internet, mbrojtjen e të dhënave personale, rregullimin e industrisë së telekomunikacionit; e të ngjashme.

Industria – duhet që të ofrojë këshilla dhe udhëzime për prindër për paisjet që kanë internet e që i ofrojnë në treg, në mënyrë që prindërit kur u blejnë fëmijëve paisje të tilla të jenë të njoftuar paraprakisht me rreziqet me të cilat mund të përballen fëmijët. Të ofrojnë pako të internetit të cilat do të ishin të përshtatshme për moshat e reja dhe të ofrojnë mundësi teknike për heqjen e përmbajtjeve të papërshtatshme dhe të dëmshme për moshat nën 18 vjet.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

004:362.7-053.5

Zymeri, Teuta

Siguria e fëmijëve në internet / Teuta Zymeri, Anil Gashi
Liridon Latifi. - Prishtinë : Save the Children, 2017. – 44 f. :
ilustr. ; 21 cm.

1. Gashi Anil 2. Latifi, Liridon

ISBN 978-9951-534-51-2

SIGURIA E FËMIJËVE NË INTERNET

Këtë publikim mund ta gjeni edhe
në formë elektronike në adresën:

www.internetisigurte.org

www.fit-ks.org

<https://kosovo.savethechildren.net/>

ISBN 978-9951-534-51-2



9 789951 534512